

Mesazh falenderimi për Kryeministrin e Shqipërisë Prof.Dr.Sali Berisha



Është evident roli juaj në vlerësimin dhe përçimin e vlerave të Luftës Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, luftë kjo që e radhiti Shqipërinë përkrah Aleancës së fuqishme të popujve të drejtuar nga SHBA, Britania e Madhe dhe ish BS.

Ne vlerësojmë mbështetjen që i keni dhënë organizatës tonë dhe veçanërisht idetë dhe vizionin tuaj për rishkrimin e historiografisë shqiptare, ku padyshim, siç jeni shprehur edhe Ju, LANÇ përbën një nga faqet më të ndritura të saj. (Faqe 2)



Veterani

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)
GAZETË DYJAVORE. NR. 61 (292) 16-31 KORRIK 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com

Kostoja e mandatit të 84-t

Halil RAMA

Vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për t'i hequr një mandat mazhorancës së re duke e "rrëzuar"atë në 83 mandate deputetësh, ka shkaktuar reagime të ashpra në të dy kampet e politikës shqiptare.

E djathta denoncoi mesazhet kërcënuese me jetë ndaj përfaqësuesit ligjor të Partisë Demokratike në KQZ, Njazi Kosovrasti, pas deklaratave të tij të guximshme lidhur me rezultatin e zgjedhjeve në qarkun e Lezhës. Përfaqësues të së majtës paralajmëruan ndërkohë se do ta mbrojnë me gjak mandatin e "rrëmbyer".

Gjithsesi, nëse ky vendim i KQZ mbetet në fuqi, të majtët humbin mandatin e 4 në qarkun e Lezhës, i cili u ka kaluar demokratëve që tashmë arrijnë të përmbysin rezultatin e përgjithshëm në këtë qark në 4 me 3. Për këtë ka mjaftuar ndërhyrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili nuk ka njohur rezultatin e sjellë nga KZAZ-ja 13 në qytetin e Lezhës për 10 kuti votimi, me argumentin se ato ishin të falsifikuara dhe ka përfshirë në tabelën përmbljedhëse të rezultatit të dhënat që jep sistemi elektronik i këtij institucioni. Falë këtij operacioni, e djathta në këtë qark ka rikuperuar plot 541 vota nga këto 10 kuti, duke dalë në fund të të gjithë procesit 39 vota para koalicionit të majtë, çka i kanë mjaftuar për të kthyer raportin e mandat-eve në 4 me 3 në favor të saj.

Po çfarë ndryshon një mandat më pak për mazhorancën e re?

Kostoja e vetme e saj është humbja e një mandati të së majtës e cila nuk mund të jetë më mazhorancë absolute, pra nuk do t'i ketë 84 mandatet për të kryer e vetme disa reforma të thella legislative.

Nëse edhe Kolegji Zgjedhor lë në fuqi këtë vendim të KQZ shqiptarët mund të shpresojnë në kompromisin pozitë-opozitë për këto reforma aq të domosdoshme për ta përafëruar Shqipërinë me Bashkimin Europian. Dhe padyshim, në serialin e këtyre reformave, parësore është ajo kushtetuese. (vijon në faqen 3)

FAQE 3

LANÇ, EPOKA MË E NDRITUR NË HISTORINË E SHQIPËRISË

70 VJET MË PARË,LUFTA PERMET -KUQAR -QAFJA E KIÇOKUT-GRYKA E KELCYRES-SHKALLA BARMASHIT (1-6 KORRIK 1943)



FAQE 4-5

Prezantohen në detyrat funksionale gjeneralët e rinj të Forcave të Armatosura

Ceremonia e parë është zhvilluar në Komandën e Forcës Ajrore ku gjeneralmajor Gjünkshi prezantoi komandantin e ri të kësaj strukture të rëndësishme të FA të Shqipërisë, gjeneral brigade Frederik Beltoja

FAQE 2

Qeveria e Kosovës është e përgatitur që të fillojë sa më shpejt negociimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim

Kosova e gatshme për negociatat për MSA-në

FAQE 8

KRYETARI I KOMUNËS SË KURVELESHIT SHTRON DREKË PËR NDER TË HEROIT TË POPULLIT RRAHMAN PARLLAKU

Përkujtohet 70-vjetori i rënies së Heroit të Popullit Asim Zeneli

FAQE 6

Margarita dhe Kristaq Tutulani, shembull i sakrificës dhe vetmohimit

VETËM NE VITET E DEMOKRACISË AI U NDERUA DHE U RESPEKTUA, SIÇ E MERITONTE

Ibrahim Xherri, partizani trim që u burgos nga diktatura

FAQE 6

Ministri i Mbrojtjes Imami dekoron tre ekspertë amerikanë të kompanisë CUBIC

Ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami, ka dekoruar tre ekspertë amerikanë: kolonel (R) Louis L. Boros, kolonel (R) Calvin L. Peterson dhe kolonel (R) Gregory A. Cannata, të cilët që nga viti 2007 punojnë si përfaqësues të kompanisë CUBIC pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë: ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, zëvendësministrat e Mbrojtjes, z. Ekrem Spahiu dhe znj. Arta Musaraj, gjeneralë dhe drejtorë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA, etj.



Pasi u bë një prezantim i shkurtër i punës dhe veprimtarisë së tre ekspertëve amerikanë, ministri i Mbrojtjes Imami u dorëzoi atyre medaljen "Për Shërbime të Shquara" me këtë motivacion: "Për kontributin e dhënë nëpërmjet ekspertizës dhe këshillimit për reformimin e Mbrojtjes dhe zhvillimin e FA Shqiptare". Më pas, ministri Imami,

duke vlerësuar kontributin e tyre theksoi: "Është një nder dhe privilegj për mua që kemi punuar së bashku për disa objektiva, reforma dhe standarde, të cilat ishin të domosdoshme për anëtarësimin në 2009 të vendit tonë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Sigurisht, në radhë të parë falënderoj Departamentin Amerikan të Mbrojtjes që na ka siguruar në vijimësi këshillim dhe mbështetje". Më tej, duke shprehur mirënjohjen për meritat e veçanta të zotërinjve Boros, Cannata dhe Peterson, z. Imami nënvizoi se nuk ka asnjë reformë të rëndësishme në ushtrinë tonë këto katër vite, e cila të mos jetë

flikt opinionesh, por kemi arritur që t'i japim të drejtë njëri-tjetrit dhe të ecim përpara për të mirën e këtij vendi, të kësaj ushtrie dhe për Aleancën. Në këtë kontekst, medaljet "Për Shërbime të Shquara" janë shprehje e mirënjohjes që kemi për ju. Unë shpresoj që mandati juaj do të vazhdojë dhe se CUBIC duhet të vazhdojë të punojë akoma në Shqipëri sepse është një ndihmë e kualifikuar, një memorie e pandërprerë dhe një garanci që reformat në këtë ministri dhe në FA Shqiptare të jenë koherente. Jam i lumtur për bashkëpunimin dhe ju uroj gjithë të mirat në familjet tuaja", - ka përfunduar fjalën e tij, ministri Imami.

Kolonel (R) Louis L. Boros, njëkohësisht shefi i CUBIC, në emër edhe të kolegëve të tij, ka falënderuar ministrin e Mbrojtjes Imami për vlerësimin që i bëri punës dhe kontributit të tyre. "Është një kënaqësi dhe nder për ne që sot na akordohet kjo medalje. Skuadra jonë ka 72 muaj që punon në Shqipëri dhe gjatë gjithë kësaj kohe ne kemi qenë larg familjeve tona për të kryer këtë mision për arsye se është shumë i rëndësishëm". Ai ka theksuar gjithashtu se në punën tonë kemi qenë të mbështetur nga një staf shqiptar i shkëlqyer dhe se kjo ishte një eksperiencë shumë e mirë për ta, pasi CUBIC u përfshi në një mision kritik dhe shumë të vështirë, por që Shqipëria po e realizon shumë mirë. "Ju jeni duke u bërë një aleat i çmuar brenda NATO dhe reputacioni juaj sa vjen dhe rritet. Shumë faleminderit për medaljet dhe ne i vlerësojmë ato si inkurajim për punën tonë në të ardhmen", - ka përfunduar z. Boros.

Prezantohen në detyrat funksionale gjeneralët e rinj të Forcave të Armatosura

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, me ceremoni të veçanta ka prezantuar më 9 korrik 2013 komandantët e rinj të Forcës Ajrore, Brigadës së Mbështetjes Rajonale dhe drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes.

Ceremonia e parë është zhvilluar në Komandën e Forcës Ajrore ku gjeneralmajor Gjunkshi prezantoi komandantin e ri të kësaj strukture të rëndësishme të FA të Shqipërisë, gjeneral brigade Frederik Beltoja, i cili pak ditë më parë me dekret të Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani i është dhënë grada gjeneral brigade. Duke marrë fjalën në këtë ceremoni, gjeneralmajor Gjunkshi u shpreh: "Gjeneral brigade Beltoja vjen në këtë detyrë të re pasi ka kryer me dinjitet detyrën zëvendëskomandant i Forcës Ajrore dhe me një eksperiencë të pasur pune në detyra të tjera të rëndësishme në FA. Unë besoj që gjeneral brigade Frederik Beltoja



me cilësitë që e karakterizojnë dhe me mbështetjen tuaj do të çojë edhe më lart sukseset e Komandës së Forcave Ajrore".

Një atmosferë festive ka vijuar edhe në ambientet e Brigadës së Mbështetjes Rajonale, ku gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi ka prezantuar komandantin e ri të kësaj

njësie ushtarake, gjeneral brigade Muhamet Buçpapa. "Besoj se gjeneral brigade Muhamet Buçpapa, me cilësitë dhe aftësitë që e karakterizojnë do të çojë edhe më lart historinë e suksesit të Brigadës së Mbështetjes Rajonale. Unë i uroj

OBVL, mesazh falenderimi për Kryeministrin e Shqipërisë Prof.Dr.Sali Berisha



I nderuar z.Berisha!

Kryesia e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare shpreh vlerësimin maksimal për kontributin tuaj madhor në shembjen e regjimit më gjakatar që ka njohur historia, themelimin e pluralizmit politik dhe të Partisë Demokratike, për krijimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor.

Kontributi juaj në këta dy dekadat e fundit është evident kudo. Ju si askush tjetër realizuat aspiratën e popullit shqiptar: anëtarësimin e Shqipërisë në Këshillin e Europës dhe në NATO, afrimin e vendit tonë fare pranë Bashkimit European.

Është evident roli juaj në vlerësimin dhe përcimin e vlerave të Luftës Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, luftë kjo që e radhiti Shqipërinë përkrah Aleancës së fuqishme të popujve të drejtuar nga SHBA, Britania e Madhe dhe ish BS.

Ne vlerësojmë mbështetjen që i keni dhënë organizatës tonë dhe veçanërisht idetë dhe vizionin tuaj për rishkrimin e historiografisë shqiptare, ku padyshim, siç jeni shprehur edhe Ju, LANÇ përbën një nga faqet më të ndritura të saj. Ju dhe qeveria juaj bëtë re-

alitet Shqipërinë e zhvilluar me infrastrukturë moderne, ku veçanërisht Rruga e Kombit, Tuneli i Krrabës dhe autostrada Tiranë - Elbasan janë përmendore që mbajnë vetëm emrin tuaj.

Në zgjedhjet e 23 qershorit, për të cilat ju u angazhuat maksimalisht për t'i zhvilluar konformë standardeve europiane, të certifikuara si të tilla edhe nga organizmat prestigjiozë ndërkombëtare, Ju shpalosët projektin e Shqipërisë së zhvilluar. Ndonëse nuk u votua masivisht, ky projekt mbetet për sot dhe në të ardhmen në themelet e programeve të mazhorancave që do të vijnë.

Ndërsa me aktin e dorëheqjes nga funksionet drejtuese në PD ju demonstruat sërish forcën dhe vitalitetin e një burri të shquar shteti.

Ju ishit dhe mbeteni ideatori dhe frymëzuesi i fitoreve të reja të së djathtës reale shqiptare, të cilat padyshim që do të jenë të afërta.

Edhe njëherë ju konfirmojmë vlerësimin dhe njëherësh mbështetjen tonë maksimale.

Ju urojmë shëndet Ju dhe Familjes tuaj.

KRYESIA E OBVL
Tiranë, më 08.07.2013.

gjeneral Buçpapës suksese dhe e siguroj për mbështetjen e vazhdueshme të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes", - ka theksuar në fjalën e tij, gjeneralmajor Gjunkshi. Ceremonia e zhvilluar në Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes ka shënuar mbylljen e prezantimeve të drejtuesve më të rinj të strukturave të FARSH. Këtu gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi ka prezantuar drejtorin e Përgjithshëm, gjeneral brigade Ylber Dogjani. Gjatë prezantimit të tij, gjeneralmajor Gjunkshi ka vlerësuar punën dhe përvojën e gjatë të gjeneral brigade

Dogjani dhe ka shprehur besimin e tij se ai do të çojë më lart sukseset e Agjencisë së Inteligjencës së Mbrojtjes në përputhje me kërkesat e standardet e NATO.

Të tre gjeneralët e rinj kanë siguruar shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi për një angazhim maksimal në kryerjen e detyrave të rëndësishme që ata kanë marrë dhe se strukturat dhe efektivat që ata do të drejtojnë do të përmbushin me nder të gjitha detyrat që do t'i ngarkohen nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA.

Kryetari i Komunës së Kurveleshit shtron drekë për nder të Heroit të Popullit Rrahman Parllaku

PËRKUJTOHET 70-VJETORI I RËNIES SË HEROIT TË POPULLIT ASIM ZENELI

• I mallëngjyer nga vizita në ato vende ku i vinin në kujtesë shokët e shoqet e rinisë, Z.Rrahman Parllaku nderoi me respekt të veçantë kujtimin e 23 ish luftëtarëve të lirisë që mbetën të vrarë e të ngrirë në borë në luftimet e 2-6 shkurtit në Salari e Malin e Këndrevicës së Dhemblanit. Po ashtu ai solli në kujtesë edhe shumë të tjerë të plagosur të cilët mbetën invalid për jetë

Komuna e Kurveleshit dhe Organizata e Familjeve të Dëshmorëve të LANÇ organizuan një ceremoni përkujtimore, në 70-vjetorin e rënies së Heroit të Popullit, Asim Zeneli. Pranë memorialit të tij në Grykën e Këlcyrës vendosi një kurorë me lule dhe përshëndeti të pranishmit edhe kryetari i OBVL-së

Z.Isa Tare, kreu i OBVL bëri një vizitë në komunën e Kurveleshit. Bashkë me ta, Z.Parllaku vizitoi familjen e vëllait të Heroit të Popullit Hito Çako (Xhavjek Çako), familje kjo ku ai është pritur e strehuar në vitet e zjarrit të Luftës Antifashiste Nacionalç-lirimtare.

Mjaftë mbresëlënëse ishte dreka

Z.Parllaku, solli në vëmendje kujtimet e disa betejave luftarake të zhvilluara në këtë krahinë, kundër okupatorëve nazifashistë, në të cilat ai ka qenë pjesëmarrës.

Pjesëmarrësit ndoqën me vëmendje kujtimet e z.Parllaku për thyerjen e Operacionit nazist të Dimrit 1943-1944, në atë terren malor dhe



Pjesëmarrësit ndoqën me vëmendje kujtimet e z.Parllaku për thyerjen e Operacionit nazist të Dimrit 1943-1944, në atë terren malor dhe në kushtet e një dimri tejet të ashpër, ku partizanët bënë sakrifica mbinjerëzore

veçantë, vëllazërore e të ngrohtë.

I mallëngjyer nga vizita në ato vende ku i vinin në kujtesë shokët e shoqet e rinisë, Parllaku nderoi me respekt të veçantë kujtimin e 23 ish luftëtarëve të lirisë që mbetën të vrarë e të ngrirë në borë në luftimet e 2-6 shkurtit në Salari e Malin e Këndrevicës së Dhemblanit. Po ashtu ai solli në kujtesë edhe shumë të tjerë të plagosur të cilët mbetën invalid për jetë.

Z.Parllaku foli për sakrificat sub-

lime që bënë luftëtarët e lirisë në moshën e rinisë dhe të adoleshencës 13-15 vjeçare.

Kryetari i OBVL u bëri thirrje autoriteteve vendore, të rinjve dhe të rejave që të kujdesin për mirëmbajtjen e memorialëve e të varrezave të dëshmorëve, si pjesë e historisë sonë kombëtare..

Bashkë me mallëngjimin, z.Parllaku pati kënaqësinë të shohë vendin që po rilind nga puna e popullit tonë vital.



Rrahman Parllaku, i cili mori pjesë në këtë veprimtari përkujtimore, me ftesë të autoriteteve lokale të komunës së Kurveleshit.

Pas ceremonisë, i shoqëruar nga kryetari i komunës, Z.Milori dhe nga

e shtruar nga kryetari i Komunës së Kurveleshit për Heroin e Popullit Rrahman Parllaku, gjeneral - lejtentant në pension. Në këtë drekë ku merrnin pjesë dhe vetëranët të LANÇ e të ftuar të tjerë, me kërkesën e tyre,

në kushtet e një dimri tejet të ashpër, ku partizanët bënë sakrifica mbinjerëzore.

Kryetari i OBVL falenderoi kryekomunarin e Kurveleshit, Z.Milori për ftesën dhe mikpritjen e

Kostoja e mandatit të 84-t

(Vijon nga faqja 1)

Nëse LSI, që në zgjedhjet e 23 qershorit arriti të dalë forcë e tretë duke trefishuar peshën e saj elektorale mbetet e angazhuar që të përbushë premtimin për ndryshimin e Kushtetutës, të paktën në kreun e sistemit zgjedhor, këtë duhet ta fiksojë si aksionin e saj të parë politik. Kjo për faktin se edhe këto zgjedhje dëshmuar deformimin e vullnetit të shqiptarëve në proporcion me mandatet e prodhuara nga vota e tyre.

Ky deformim është i përmasave të frikshme po të krahasosh rezultatet nga njëri qark në tjetrin. Rasti më specifik: Qarku i Lezhës rrëzon mandatin e 84 të mazhorancës me vetëm 34 vota që e djathta ka më shumë se koalicioni i majtë, ndërsa në qarkun e Dibrës numri i mandatëve (3 me 3) nuk ndryshon, ndonëse

Partia Demokratike ka 5000 vota më shumë se Partia Socialiste. E njëjta situatë edhe në Kamëz, e cila mbetet bastion i PD me mbi 7000 vota më shumë se Partia Socialiste.

Dy zgjedhjet e fundit parlamentare provuan se këtë hendek mes vullnetit të sovranit dhe numrit të mandateve të deputetëve që prodhohen nga deformimi i votës së tyre e bën më të thellë pikërisht sistemi ynë aktual zgjedhor.

Nëse para ndryshimit të tij me metoda radikale në 2008 nga demokratët dhe socialistët, deputetët e LSI u ngujuan në sallën e parlamentit (në grevë urie), tashmë ata duhet të ngrihen mbi vetveten si përcaktues në vendimarrjen e legjislativit të ri. Kjo për faktin se këto zgjedhje evidentojnë dhe hapësira boshe në legjislacionin zgjedhor të Shqipërisë, që sollën në anal-

izë të fundit, deformimin e vullnetit të zgjedhësve.

Nuk është thjeshtë mungesa e mandatit të 84, sepse atë mund ta sigurojë edhe nëpërmjet trafikimit të ndonjë deputeti siç ka ndodhur rëndom në të kaluarën, por sepse reforma kushtetuese kërkon domosdoshmërisht kompromisin e të dyja palëve.

Amplituda e kësaj reforme është shumë e gjerë: që nga administrimi i procesit zgjedhor dhe shpolitizimi i KQZ-së, deri tek transparenca e financimeve të zgjedhjeve. Kjo për faktin se, ndonëse askush s'e vë në dyshim fitoren e së majtës në zgjedhjet e 23 qershorit, i dyshimtë mbetet certifikimi i mandateve. Atë kurrësesi nuk mund ta bëjë një KQZ e cunguar vetëm me 4 anëtarë, ndërkohë që të majtët e kanë bojkotuar këtë institucion që prej dy muajsh.

Legjislativi i ri ka në dorë t'i japë fund kësaj tradite, që ka prodhuar vetëm kriza politike dhe ka rritur mungesën e besimit mes palëve. Ka ardhur koha që të krijohet një institucion zgjedhor që në emërtimin e tij të jetë jopolitik. Një formulë e njohur edhe në vendet tjera me demokraci të konsoliduara është krijimi i autoritetit të pavarur për administrimin e zgjedhjeve.

Në përbërje të tij mund të jenë 7 anëtarë si tani, por ndryshe nga tani, ata nuk duhet të vijnë nga partitë politike por nga gjykatat, shoqëria civile, bota akademike dhe e mediat. Gjithsesi, prioritet mbetet ndryshimi i sistemit zgjedhor, problem kryesor i të cilit është deformimi i votës. Kodi Zgjedhor duhet të përshtatet me parimet kushtetuese dhe të mos shkelë parimin themelor të barazisë së votës. Vota

e qytetarëve duhet të jetë e barabartë dhe të përkthehet sa më drejtë në mandate deputetësh. Kjo dikton nevojën e kthimit tek sistemi mazhoritar.

Dhe nëse palët nuk bien dakord për këtë, duhet konsideruar propozimi i 23 partive politike nga të dy krahët për korrektimin e sistemit aktual, nga proporcional rajonal në proporcional të pastër ose në proporcional rajonal me korrektim kombëtar. Ndryshe nga sistemi aktual, sejcili nga këto sisteme do të përafronte dukshëm vullnetin e zgjedhësve me numrin e deputetëve të prodhuar nga vota e tyre. Në të kundër shqiptarët do të vazhdojnë të paguajnë koston e vullnetit të tyre të deformuar nga një sistem zgjedhor që prodhon sistematikisht kriza politike dhe institucionale.

Halil Rama

70 VJET MË PARË, LUFTA PERMET -KUQAR -QAFA E KIÇOKUT- GRYKA LANÇ, epoka më e ndritur në historinë e Shqipërisë

Lufta që përbën një epope të lavdishme

Viti 1943 është viti i kthesës së madhe i Luftes së Dytë Botërore. Iniciativa e luftës, në të gjitha frontet e saj, kalon në komandën ushtarake të koalicionit anti-fashist botëror. Ushtria italiane kishte pësuar goditje të rënda dhe po gjunjëzohej. Populli shqiptar ishte ngritur në luftë kundër ushtrisë italiane duke i dhënë asaj në Shqipëri goditje të njëpasnjëshme për çlirimin e saj.

Koalicioni nazi-fashist, vazhdimisht po pësonte disfatë sinë drejtim politik, ashtu dhe në atë ushtarak.

Duke analizuar këto situata të cilat vinin duke u rënduar vazhdimisht, komanda e ushtrisë italiane në Shqipëri, filloi të merrte masa paraprake për të përballuar çdo të papritur. Për këtë oje nisi të kryente punime xheniere fortifikuese në disa drejtime operative. Një nga këto drejtime operative-stretegjike ishte dhe Lugina e Përmetit që të çon deri në Qafen e Kiçokut në drejtim të Beratit dhe nga Këlcyra që të çon në drejtim të Tepelenës dhe më tutje. Për të mbuluar këtë drejtim komanda italiane vendosi të krijojë një rajon të fortifikuar në kodrat e fshatit Kuqar që ndodhet midis Përmetit e Këlcyrës, 5 km larg Këlcyrës. Këto kodra zotërojnë këtë luginë dhe mbrojnë drejtimet operative-strategjike.

Deri në Qershor të vitit 1943, d.m.th. para krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, çetat partizane kishin luftuar në mënyrë të pavarur dhe brënda krahinave të tyre. Megjithatë ishin zhvilluar shumë beteja, të cilat kishin shkaktuar humbje të mëdha në ushtrinë italiane, mungonte një organizim i përgjithshëm, një komandë e centralizuar që do të mund të bënte veprime të koordinuara në një shkallë të gjërë dhe me forca të shumta.

Në Qershor të vitit 1943, në prapëri e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm udhëheqja e LANÇI mori vendim për të goditur repartet e ushtrisë italiane, që kryenin punime fortifikuese në kodrat e Kuqarit. Me këtë synohej gjithashtu, të goditeshin trupat e tyre dislokuara në Përmet për të çliruar këtë qytet me rëndësi.

Këto veprime luftarake do të rritnin autoritetin e LANÇI brenda dhe jashtë vendit si dhe populli ynë do të krijonte besimin më të madh për luftën tonë të drejtë.

Brenda në Përmet ishte vetëm një batalion ushtarak italian si dhe një kompani karabinjerësh. Gjithashtu si në Kuqar ashtu dhe në Tepelenë vazhdonin punimet fortifikuese që kryeshin nga dy batalione të tjera italiane.

Asgjësimi i këtyre forcave do të

siguronte një kompaktësi më të madhe të zonave Pogon, Zagori, Dëshnicë, Përmet, Dangëlli e Leskovik. Çlirimi i Përmetit do të kishte një rëndësi të madhe politike sepse do të ishte i pari qytet i çliruar i Shqipërisë.

Karakteristika e luftes Përmet-Kuqar-Qafa e Kiçokut-Gryka e Këlcyres dhe Shkalla e Barmashit, ishte se për herë të parë merrnin pjesë forcat partizane të tre qarqeve nën një komandë unike.

Për kryerjen e këtij operacioni me një hapësirë rreth 150 km katror udhëheqja e LANÇI vendosi të formonte një forcë operative të tre qarqeve Korçë, Berat dhe Gjirokastrë. Nga Qarku i Korçës ishte Nexhip Vinçani e Pëllumb Dëshnica, nga qarku i Beratit Xhelal Staravecka, kurse nga ai i Gjirokastrës Islam Radovicka e Tahir Kadare. Në shtabin operativ ishin dhe dy oficerë anglez, ndër lidhës me komandën ushtarake të Mesdheut. Komandanti i operacionit u caktua Nexhip Vinçani, ndërsa Shtabi Operativ u vendos në shtëpinë e patriotit dhe bashkëluftëtarit të Çerciz Topullit, Riza Velçishtit. Partizanët pas një marshimi të gjatë e të lodhshëm, sepse vinin nga krahina të ndryshme, u vendosën në varësi të zonave ku do të kryenin veprimet luftarake.

PLANI LUFTARAK

Për zbatimin e detyrës, komandanti i operacionit Nexhip Vinçani, pasi u orientua me terrenin dhe pasi vlerësoi forcat partizane dhe ato italiane vendosi:

1-Goditja kryesore do të jepej kundra trupave italianë në Kuqar. Nga veri-lindja do të sulmonte batalioni "Ali Këlmendi" me komandant Teki Kolanecin dhe komisar Faik Zaimin. Në krahun e majtë të tij do sulmonte batalioni "Themistokli Gërmenji" me komandant Ali Vinçanin dhe komisar Spiro Shalësin dhe në krah të tij batalioni "Hakmarra" me komandant Petrit Dumen dhe komisar Josif Pashkon.

Nga ana e kundert, në bregun e majtë të lumit Vjosa, do të mbështeste sulmin me zjarr çta e Rrëzës së Përmetit e komanduar nga Riza Çaçi, për të mos lejuar ushtarët italianë të bënin manovrime apo të merrnin ujë në Vjosë.

2- Goditja tjetër do të jepej kundër forcave italiane të vendosur në qytetin e Përmetit, me forcat e batalionit "Fuat Babani", i cili komandohej nga Tefik Cakoni dhe komisar Muzafer Spaho sidhe një kompani e batalionit "Riza Cerova", Skrapar, që komandohej nga Shaqir Kapinova. Detyra e këtyre forcave ishte të asgjesonin trupat italiane të vendosura në kazerma dhe të çirohej qyteti i Përmetit.

3- Për sigurimin e operacionit nga goditjet e forcave italiane që mund të vinin nga drejtimi Berat-Përmet, u vendosën në Qafen e Kiçokut dy kompani të batalionit "Riza Cerova", të komanduara nga Neshat Hysi. Ky batalion u formua më 26 qershor 1943 në Qafen e Martës, me komandant Xhelal Staraveckën dhe komisar Ramis Aranitasin. Këta, mbasi marshuan ditë e natë nga Camëria-Vithkuqi-Selenica-Orgocka-Odriçani dhe Suka, më 30.06.1943 mbërritën në Qafën e Kiçokut. Për zbatimin e detyrës forcat partizane u vendosën në dy anët e rrugës automobilistike që kalon në Qafën e Kiçokut, në Bregun e Stanit, në Bregun e Korijes, në atë të Xanës si dhe te Përroi i Burimit.

4- Në drejtimin Tepelenë-Përmet, zunë pritë tek gryka e Mezgoranit, Çeta "Musa Fratarit" me komandant Feti Bubsin dhe komisar Dashnor Mamaqin sidhe Çeta "Koto Hoxhi" me komandant Pano Xhamballan dhe komisar Vasil Katin. Detyra e tyre ishte për të ndaluar ardhjen e forcave italiane nga Tepelena në ndihmë të forcave në Kuqar dhe Përmet.

5- Batalioni territorial i krahinës së Çepanit, i komanduar nga Xhemal Malindi dhe komisar Iliaz Sevrani, zuri pritë në grykën e Këlcyrës.

6 - Në drejtimin Korçë-Përmet, zunë pritë në Qafën Shkalla e Barmashit çetat e Çamërisë dhe Panaritit të komanduara nga Riza Kodheli, Çeta e Potomit e komanduar nga Bajram Krasta sidhe partizanë dhe vullnetarë nga Kolonja.

7 - Vendvrotimi i komandës së operacionit u vendos në një koder 600 m në jug-lindje të kodrave të Kuqarit.

8 - Sulmi do të bëhej në orën 4:00 të dates 1 korrik 1943.


Komanda e operacionit dha një varg udhëzimesh mbi ndër lidhjen, bashkëveprimin, mbi furnizimin e partizanëve me ushqime si sidhe për shërbimin shëndetësor.

Sipas vendimit, naten, duke gdhirë 1 korriku, batalionet dhe çetat që do sulmonin garnizonin e Kuqarit dhe të Përmetit, zunë vendet e caktuara, kurse batalionet dhe çetat e tjera u pozicionuan nëpër prita.

Kur partizanët po prisnin sinjalin për të filluar sulmin, ndodhi diçka e pa pritur. Një autokollonë italiane, e përbërë nga 5 kamionë, një autobлиндë dhe një motoçikletë, që po udhëtonte nga Përmeti në drejtim të Këlcyrës, ndeshi në një minë dhe për pasojë motoçikleta u hodh në erë.

Partizanët genë detyruar të hapnin zjarr në drejtim të kollonës të cilën dhe e asgjësuan. Automjetet u dogjën, kurse shumica e ushtarëve mbetën të vrarë.

Batalioni Italian i Kuqarit, që



bënte punime fortifikuese, me të degjuar goditjen e aotokolonës, i la punimet dhe mori masa mbrojtje. Partizanët atëhere u hodhën në sulm. Pas Kuqarit luftimet u ndezën dhe në Përmet. Luftimet vazhduan gjithë naten dhe ditën e nesërme të 1 korrikut.

Në Kuqar ku jepej goditja kryesore, partizanët kryen disa mësymje rradhazi, por italianët mbroheshin me këmbëngulje duke u përgjigjur me zjarrin e fuqishëm të armëve të tyre dhe duke mos treguar asnjë shenjë dobësimi. Ata i ndihmonin shumë fortifikatat dhe telat me gjëmba që kishin rreth e qark. Akoma më shumë guxim morën, sidomos, kur në mëngjezin e 2 korrikut në qiell u dukën aeroplanët luftarakë italianë që erdhën në ndihmë të tyre. Sapo u afruan, ata nisën menjëherë bombardimin dhe mitralimin mbi pozicionet e partizanëve.

Në Përmet batalioni italian u izolua në kazerma i goditur nga çdo anë prej zjarrit të partizanëve. Megjithatë njësi gueril i Përmetit preu tubin që i furnizonte me ujë, italianët mbroheshin me këmbëngulje. Batalioni i tyre kishte shumë murtaja të cilat hidhnin predha pa pushim në pozicionet e partizanëve. Ndërkohë një batalion i Italianëve, i përforcuar me artileri dhe një autobлиндë, nga mesi i ditës së 2 Korrikut filloi lëvizjen nga Dragoti për të dalë në Këlcyrë e Kuqar. Forcat partizane që mbronin

grykën i kundërsulmuan ashpër dhe i thyen. Bashkë me çetat "Musa Fratarit" dhe "Koti Haxhi", natën u bashkua dhe çeta "Haredin Tremishiti" me komandantë Xheladin Beqirin (Karadaku) dhe komisar Asim Zeneli.

Në mbrëmje italianët mundën të shpërthejnë qëndresën e partizanëve dhe të arrijnë në Këlcyrë. Prej andej u hodhën në Kuqar, ku u bashkuan me forcat e tjera të rrethuara, duke u bërë gjithsej dy batalione. Këtu sulmet e partizanëve u bënë të pamundura, prandaj ata mbetën në pozicionet e mëpërparshme.

Në orën 4 e 30 te 2 Korrikut, nisën luftimet në Qafën e Kiçokut. Dy batalione Italiane, një bersalierësh dhe një këmbëzgjish, të ngarkuar në 55 kamionash, që shoqeroheshin dhe nga tre autoblinda, donin të çanin rrugën për të arritur në Kuqar dhe Përmet. Partizanët e batalionit "Riza Cerova" qëllimisht i lanë Italiananët të futeshin në pritën e ngritur dhe pastaj u dhanë goditje të forta. Luftimet e ashpra zgjatën rreth 10 orë.

Kur ata e panë se nuk po e çanin dot rrugën, vendosën të tërhiqeshin, por dhe tërheqja nuk qe fortë e lehtë, sepse kthimi i makinave në rrugën e ngushtë pati vështirësi. Kjo u kushtoi atyre mjaft të vrarë dhe shumë dëme materiale.



E KELCYRES-SHKALLA BARMASHIT (1-6 KORRIK 1943)



Përveç kamionëve të shkatëruar dhe një autoblinde të djegur, ata lanë në vënd 5 makina dhe një motoçikletë, të cilët u përdorën nga partizanët. Aty u kap dhe një sasi e madhe municionesh e materiale të tjera të vlefshme. Luftimet tona u mbështetën fuqimisht dhe nga zjarri i mitralozit të rëndë "Bredan" që përdorej nga trimi Ferit Radovika nga Bregu I Golemit. Në këto përleshje me trupat italiane ra në fushën e luftës Tajar Hysi, i cili megjithëse u plagos rëndë, u zu gryka-grykës me 5 italiane. Tek kodra e Bregut u vranë Sabri Kacidhia dhe Taip Çela. Po kështu duke luftuar me guzim u vranë: Xhevahir Temani, Haxhi Mborja, një partizan nga Terrova e Beratit dhe Shaban Polena nga Skrapari. Në Kuqar partizanët mundën të shkullnin italianët nga llogoret e vijës së parë të mbrojtjes, ku gjatë luftimeve u vranë Jonus Çuçi e Kosta Goliku. Batalioni teritorial i krahinës së Çepanit futi në dorë Këlcyren dhe bllokoi rrugën automobilistike, por më tutje ndaluan nga ballistët e Ali Këlcyres të cilët dhanë ultimatum se do të fillonin luftë kundër partizanëve nëqoftëse nuk largoheshin nga Gryka e Këlcyres. Me urdhër të Nexhip Vincanit, batalioni u vendos në Shtikë.

Në Përmet po në datën 3 Korrik, partizanët ngushtuan shumë rrethimin e italianëve, të cilëve u kishin mbetur në duar vetëm një pjesë e gazermave. Ata rezistonin dhe mbroheshin duke zhvilluar luftime të ashpër.

Aviacioni italian dyfishoi goditjet në krahësim në ditët e mëpërparshme duke bombarduar dhe mitraluar partizanët, por pa shkakuar dëme të mëdha. Nga ajri aeroplanët hidhnin ushqime dhe municione për trupat e rrethuara në Kuqar. Partizanët përpiqeshin të qëllonin italianët që mblidhnin

parashutat, por ata, për çudi nuk dukej të shqetësoheshin ndaj goditjeve të tyre.

Atëherë, komandanti i kompanisë së batalionit "Ali Kelmendi", Selami Velçani vjen dhe i shqetësuar i raporton komandantit të operacionit për këtë problem. Xhelal Staravecka pasi e dëgjoi, kthehet nga unë dhe më thotë: "Shko Skënder një vrap dhe shiko si është puna". Me shpejtësi arrij tek pozicionet e partizanëve dhe pasi lëshoj ca të shtëna në arën ku hidheshin parachutat shikoj se plumbat nuk rrahin aty ku shënoj unë por nxjerrin tym rreth 100 metër më afër. Duke e kuptuar menjëherë se ku "çalonte gomari", gradoj malherin e gjatë në shënjestrën 6 dhe shoh që tani plumbat po arrijnë në objekt. Atëherë i kthehen Selami Velçanit dhe i them të udhëzojë partizanët që të rregullojnë shënjestrën. Breshëritë e mëparshme dhe pluhuri që mbuloj parachutat treguan që ky problem "elementar" u zgjidh me sukses. Këtu, do të doja të theksoj, që partizanët, në pjesën dërmuese fshatarë shpesh nuk kishin përvojën e duhur me armët dhe funksionin e tyre. Lufta do të ishte shkolla ku ata shumë shpejtë do të specializoheshin, duke formuar kështu një ushtri, e cila do të ishte e aftë të kryente misionin për të cilën ishte formuar.

Në qafen e Kiçokut vazhdonin luftimet ndërmjet partizanëve dhe kolonës italiane të bllokuar në Lajthizë. Për të zhbllokuar kollonën, komanda italiane nisi nga Berati forca të tjera të ngarkuara me 40 makina. Këto forca u goditën me forcë nga partizanët e Skraparit dhe çeta vullnetare e Terpanit duke u bllokuar aty deri në mbrëmjen e 4 Korrikut.

Të nesërmen në mëngjezin e 5 Korrikut, të dyja kollonat italiane u bashkuan në Lajthizë, ku formuan një forcë me rreth 2000 mijë ush-

tarë dhe lëvizën drejt Përmetit. Me ndihmën e artilerisë dhe të aviacionit italian ata mundën të mposhtnin qendrën e partizanëve në Qafën e Kiçokut dhe të arrijnë në mbrëmje në Këlcyrë.

Mbrritja e një fuqie kaq të madhe, rrezikonte forcat partizane në Kuqar dhe Përmet prandaj dhe komandanti i operacionit vendosi tërheqjen e tyre, e cila u bë me rregull të plotë.

Italianët, më 6 Korrik u futën në Përmet, i cili ishte i boshatisur nga partizanët dhe banorët e tij. Ata dogjën të gjitha dyqanet dhe shëpitë e qytetit. Në total u dogjën 177 dyqane, 125 shtëpi dhe 10 godina të administratës qeveritare. Dogjën gjithashtu dhe Këlcyrën, por këtu u zgjodhën vetëm godinat që ishin pronë e partizanëve, si hoteli i Xhemal Malindit, ai i Abaz Sevranit dhe disa të tjerë duke përjashtuar ato që ishin prona të Ali Bej Këlcyres. Nënprefekti i Përmetit i cili shkoi në Gjirakastër, tregonte se si ushtria italiane si rapreziale, dogji gjithë qytetin e Përmetit, të cilin gjatë luftimeve dhe e kishte bombarduar me aviacion. "Lajmet njoftojnë edhe djegien e Këlcyres dhe të shumë katundeve. Ushtria është duke djegur arat me grurë dhe katundet rreth Përmetit. Popullsia ka marrë shpëllat e qytetit dhe është pa bukë e strehë..."

Komanda e 9 - të e armatës së trupave Italianë pohonte: "Ditën e 1 Korrikut në teritorin e divizionit "Parma" u dhanë njëkohësisht katër goditje nga kryengritësit me një këmbëngulje dhe shtjellim forcash deri më sot të pa parë. Veprimet luftarake gjatë boshtit Berat - Këlcyrë - Përmet dëshmojnë për një ide të gjërë, për një përgatitje të kujdesshme dhe këmbëngulëse, si dhe për një bashkërendim të qartë të aksionit.

Lufta Përmet-Kuqar-Qafa e Kiçokut-Grykë e Mezhgoranit-Shkalla e Barmashit, u karakterizua nga pjesëmarrja në të e një sasi të konsiderueshme të forcave partizane të tre qarqeve, e cila u zhvillua në një hapësirë prej 150 km katrore dhe e drejtuar nga një komandë e vetme. Një operacion i tillë, unik, nuk u përsërit më gjatë gjithë luftës partizane

Në mëngjesin e 6 Korrikut, një divizion gjerman me automjete lëvizi nga Follorina në drejtim të tokës shqiptare. Ai hyri në Korçë dhe duke vazhduar rrugën për Janinë, në Shkallën e Barmashit u ndesh papritur me një zjarr të dendur. Ishte ora 15 e 30 e dates 6 Korrik. Nga zjarri i partizanëve u shkaterrua një motoçikletë që ra në minë dhe disa makina ku u vranë disa ushtarë nazistë. Gjermanët tentuan me çdo kusht për të vazhduar lëvizjen përpara por nuk mundën. Një autobлинд doli në krye të kolonës por ndeshi në një minë tjetër dhe u shkatërrua. Luftimet vazhduan 7 orë deri në mbrëmje vonë. Për humbjet e pësura gjermanët, më 6 korrik në Borovë, pushkatuan 107 vetë dhe dogjën gjithë fshatin.

Përsa i përket raporteve të Ballit Kombëtar me partizanët, goditja e parë ndërmjet këtyre dy forcave ndodhi në fshatin Kurtës të Kolonjës.

Partizanët e batalionit "Fuat Babani" gjatë rrugës nga Përmeti për në Devoll kaluan përmes këtij fshati. Ballistët vendalinj, sapo i panë reaguan mjehërë dhe i goditën. Kaq u desh dhe lufta u ndez e egër ku si përfundim dy partizanë mbetën të vrarë, kurse nga krahu tjetër "ktheu patkonjt" komandanti i "Balli"-t, Xhelal Kurteshi.

Ky "takim" i parë me gjakderdhje, që do të pasojë dhe me shumë të tjerë ishte një aspekt shumë i dhimbshëm që shpesh i ngjante luftës civile. Se cilat ishin motivet e kësaj përçarjeje politike, ideologjike, lufta për pushtet apo dora e huaj, përgjigjen e vërtetë ndoshta nuk do ta mësojmë kurrë. E saktë është vetëm, se ky ishte një kurban krejt i panevojshëm, sepse dhe pa të, të shumtë ishin ata që kishim bërë dhe do të bënim.

Në përfundim mund të dalim në këto konkluzione:

1. Lufta Përmet-Kuqar-Qafa e

Kiçokut-Grykë e Mezhgoranit-Shkalla e Barmashit, u karakterizua nga pjesëmarrja në të e një sasi të konsiderueshme të forcave partizane të tre qarqeve, e cila u zhvillua në një hapësirë prej 150 km katrore dhe e drejtuar nga një komandë e vetme. Një operacion i tillë, unik, nuk u përsërit më gjatë gjithë luftës partizane.

2. E meta e këtij operacioni ka qenë mungesa e një organizimi optimal dhe sigurimi i epërsisë së nevojshme të forcave në Kuqar, aty ku jepej dhe goditja kryesore. Gjithashtu nuk u morën masat paraprake efektive dhe organizative për të siguruar më mirë pritën tek Gryka e Këlcyres, prej nga italianët shpërthyen pa vështirësi të mëdha në drejtim të Këlcyres, duke u ardhur në ndihmë trupave të tyre në Kuqar, kur ato ndodheshin në gjendje kritike.

3. Pavarësisht se nuk u arrit plotësisht objektivi i caktuar për asgjësimin e trupave italiane në këtë rajon të fortifikuar, sidhe dëbimi i tyre nga gjithë rrethi i Përmetit, kjo luftë përbën një epope të lavdishme për popullin kryengritës shqiptar dhe një grusht të rëndë për ushtrinë pushtuese. Kjo luftë u shkaktoi atyre shumë të vrarë e të plagosur dhe akoma më shumë, uli krenarinë dhe moralin politik të ushtarëve italianë.

4. Kjo luftë vërtetoi se ishte i nevojshëm krijimi i një organi qendror si Shtab i Përgjithshëm, që të kordinonte e drejtonte veprimet luftarake të të gjitha forcave partizane në Shqipëri.

5. Gjithashtu kjo luftë tregoi nevojën për të krijuar njësi të mëdha partizane si brigada e divizione, të afta për të kryer veprime luftarake me rëndësi taktiko-operative.

**Marrë nga libri
"Shtigjeve të jetës" të kolonel
Skënder Malindi**

Vëlla e motër u rreshtuan në frontin antifashit në qarkorin e Beratit ku zhvilluan aktivitete për të tërhequr në luftë masat e rinisë dhe grave

MARGARITA DHE KRISTAQ TUTULANI, SHEMBULL I SAKRIFICËS DHE VETMOHIMIT

" Vëlla e motër kanë lënë pas veç shembullit të vetmohimit, edhe një arkiv letrar dhe publicistik me vlera të rralla. Poezi, prozë, shënime publicistike, përkthime, skica romanesh, janë ajo që kanë mbetur nga Kristaq Tutulani, njohës i shkëlqyer i disa gjuhëve të huaja

70 vjet më parë, në 6 Korrik 1943, në Gosë të Kavajës, shumë pranë rrugës nacionale, fashistët pushkatuan vëlla e motër nga Berati, Margarita dhe Kristaq Tutulani, për fajin e vetëm, pjesëmarrjen në luftën kundër pushtimit fashit dhe çlirimin e vendit.

Kristaqi, 24 vjeç dhe Margarita, 19 vjeç, lanë studimet jashtë vendit dhe u kthyen për të luftuar për çlirimin e atdheut, pasi aspironin për një Shqipëri të lirë, pa pushtues dhe demokratike. Për një Shqipëri të tillë, ishin dhe ëndrrat, edukata me të cilat ata u rritën në familjen Tutulani, një prej familjeve intelektuale që ndihmuan në krijimin e shtetit shqiptar.

Gjyshi i tyre, avokat Dhimitër Tutulani, si delegat i Beratit, ishte një ndër firmëtarët e Aktit të Pavarësisë në Vlorë në 28 Nëntor 1912. Ndërsa i ati, Miltiadh Tutulani, edhe ky jurist, në vitet 1922-1933 ishte deputet i parlamentit shqiptar, ndërsa si ministrër i Drejtësisë dhe Financave, kontribuo për hartimin e ligjeve të shtetit më të ri në Europë në ato vite deri sa vdiq në 1933.

Margarita e Kristaq Tutulani, të edukuar që në fëmijëri në një mjedis intelektual dhe patriot, nuk nguruan kur braktisën studimet dhe j'u bashkuan luftës. Që fëmijë ishin mësuar të betoheshin para gjyshit me fjalët "Për Atdhe dhe flamur", ndaj dhe nuk mund të qëndronin asnjëanës në një luftë çlirimtare.

Të dy u rreshtuan në frontin antifashit në qarkorin e Beratit ku zhvilluan aktivitete për të tërhequr në luftë masat e rinisë dhe grave. Pas kapjes së tyre të papritur në lagjen Mangalem në Berat në 4 korrik, që ka mbetur edhe sot pas 68 vitesh një mister, iu nënshtuan torturave nga më makabret në qelitë e SIM-it fashist italian në Berat, pa u dorëzuar. Ekzekutimi i tyre u urdhërua dhe egzekutua në 6 Korrik 1943.

Vëlla e motër kanë lënë pas veç shembullit të vetmohimit, edhe një arkiv letrar dhe publicistik me vlera të rralla. Poezi, prozë, shënime publicistike, përkthime, skica romanesh, janë ajo që kanë mbetur nga Kristaq Tutulani, njohës i shkëlqyer i disa gjuhëve të huaja.

Ish- liceist i Korçës, gjimnazist i Shkodrës dhe në fund, student i Drejtësisë në Universitetin e Firences, Kristaqi është i pari që e quajti Migjenin "uragan i ndërprerë në mes". Endërronte një Shqipëri demokratike, sipas modelit të iluminizimit francez.



Shënimet që gjenden sot në arkivat e familjes Tutulani, sikurse dhe shumë detyra studentore, evidentojnë mjaft debatet mbi të drejtat civile dhe penale të tij në Itali me pedagogët e vjetër të Universitetit, etj.

Nga Margarita kanë mbetur poezi, hartime, ditare, mbresa, përshtypje të ndryshme dhe shumë qendrisje artistike. Në ditarin e saj kur ishte nxënëse shkolle, mes rreshtave, shkruante një mesazh, që më pas do të kthehej në moton e jetës : "Atdhe! Sa e ëmbël, e bukur, tingëlluese është kjo fjalë. Por që të kesh një atdhe, duhet që të jesh i lirë".

Tronditja e madhe që u përjetua në Berat nga vrasja makabre e vëlla e motër Tutulani, jeta dhe shembulli i tyre jetësor, u përjetua brenda pak ditësh në qytetin e njëmijëdritareve.

Beratasi Vehxhi Buharaja, një nga linguistët e shquar shqiptarë, përkthyesi i madh i poezisë persiane, shkroi një poezi vetëm 10 ditë pas vrasjes së tyre, me titull "Margaritës", mes të cilave citojmë

"Zbardhi shpata,. u nxi dita,/Ra një trup,. u ngrit një emër,/Ra dëshmore Margarita,/Doli burri nga një femër..".

Nini Mano



Tronditja e madhe që u përjetua në Berat nga vrasja makabre e vëlla e motër Tutulani, jeta dhe shembulli i tyre jetësor, u përjetua brenda pak ditësh në qytetin e njëmijëdritareve

Ibrahim Xherri, partizani trim që u burgos nga diktatura

Në Durrës kujtohet me respekt të veçantë ish veterani i LANÇ, Ibrahim Xherri. Ai lindi në një familje të mesme fshatare në Aganas të Kavajës më 1923. Pasi kreu shkollën Herbert në Qerret, iu përkushtua punëve të bujqësisë.

Pas pushtimit fashist të vendit, familja e tij nuk qëndroi indiferente, por e shprehu hapur urrejtjen.

Sala, siç e thërrisnin shkurt, u lidh me Njësitin Gueril të Shkollës "Hari Fultz" në Golem dhe e shtriu aktivitetin edhe në Kavajë.

Në fund të vitit 1943, pasi kishite rënë në sy të armikut dhe ishte zbuluar veprimtaria e tij revolucionare, del partizan në çetën vendore dhe më pas inkadrohet në Brigadën e 22-të S ku luftoi deri në

çlirimin e plotë të vendit nga pushtesit nazifashistë.

Gjatë luftimeve është plagosur dy herë.

Mbas çlirimit kreu shërbimin ushtarak në komandën e vendit në Kavajë dhe më pas filloi punë në këtë komandë.

Megjithë përkushtimin dhe kontributin në luftë e në punë, një ditë prej ditësh arrestohet dhe familja e tij internohet në Kampin Tilaj-Golem. Provoi torturat e hetuesisë speciale në Durrës e Tiranë dhe pas një viti hetuesi dënohet nga ish Gjykata Ushtarake me 10 vjet burg politik.

Edhe kur doli nga burgu nuk e lanë të qetë. Fillon punë në Portin e Durrësit por pas 6 muajsh e largojnë si të padenjë. Më pas, deri sa doli në

pension punoi në ish Goma Durrës.

Ndonëse ishte një njeri i dashur dhe i respektuar nga familja dhe shoqëria, atë e ndoqi gjatë gjithë jetës hija e njollave në biografi. Madje edhe dy vjet para se të ndërronte jetë ia kujtuan vitet e burgut të tij politik. Ditën e përcjelljes për në atë botë pritej të lexohej të paktën një fjalë lamtumire, por nuk ndodhi.

Vetëm ne vitet e demokracisë ai u nderua dhe u respektua, siç e meritonte, Djali i tij vazhdon në OBVL si pasardhës i denjë veterani.

Genc BALLANCA
Kryetar i OBVL, Dega Durrës

Amnistia synon të krijojë kushte për integrimin e pjesëtarëve të strukturave serbe në Veri

Parlamenti i Kosovës miratoi ligjin për amnistinë

Në tekstin e miratuar, është kufizuar fusha e veprave që parashihet të amnistohen. Ligji përfshin amnistinë për, "sulmet mbi rendin kushtetues të Kosovës, kryengritja e armatosur, cenim të tërësisë tokësore, spiunazh, kalim të paligjshëm të kufirit, kontrabandës me mallra, shmangien e taksave, dëmtimin e pronës, zjar-rëvënien" etj.

Parlamenti i Kosovës miratoi me 90 vota pro dhe 17 kundër, projektligjin për amnistinë, që është detyrim i dalë nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Amnistia synon të krijojë kushte për integrimin e pjesëtarëve të strukturave serbe në Veri. Në tekstin e miratuar, është kufizuar fusha e veprave që parashihet të amnistohen.

Ligji përfshin amnistinë për, "sulmet mbi rendin kushtetues të Kosovës, kryengritja e armatosur, cenim të tërësisë tokësore, spiunazh, kalim të paligjshëm të kufirit, kontrabandës me mallra, shmangien e taksave, dëmtimin e pronës, zjar-rëvënien" etj.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi, njëherësh ministër i Drejtësisë tha se projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. "Unë nisem nga një

thënie filozofike që e përdor shpesh edhe vetë për drejtësinë, se kur një ligj nuk i bie tamam një populli, duhet të ndryshohet ligji dhe jo populli. Në këtë drejtim është parë që ligji i kaluar nuk i ka rënë tamam Kuvendit të Republikës së Kosovës, një pjesë të shoqërisë civile, një pjesë të subjekteve dhe individëve të tjerë dhe unë mendoj se ligji sot është i ndryshuar", tha zëvendëskryeministri Kuçi.

Projektligji mori mbështetjen e partive në pushtet dhe Lidhjes Demokratike e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në opozitë, ndërsa u kundërshtua ashpër nga Lëvizja Vetëvendosje. Kryetari i kësaj lëvizjeje, Albin Kurti tha se nëpërmjet tij po amnistohen edhe veprimet e zyrtarëve të Kosovës. "Janë bërë edhe kërkesa që ky projektligj duhet të kufizohet vetëm në ato tri komuna e gjysmë në Veri.

Mirëpo, porsa ta lexoni marrëveshjen 15 pikëshe Thaçi-Daçiq, e kuptoni që kjo nuk është e mundur: asociacioni i komunave me shumicë serbe nuk është vetëm i komunave në Veri të Ibirit, por gjithandej nëpër Kosovë; dhe strukturat kriminale e armiqësore të Serbisë ka anekënd Kosovës e jo vetëm në Veri. Prandaj, ky projektligj nuk është i kufizuar në territorin e komunave në Veri. E natyr-



ishtë që këtu po i kontrabandojnë edhe krimet e Xhabirave për t'i amnistuar. Kjo qeveri është qeveri e kontrabandës.

Ajo kontrabandon mallra në treg e njerëz në politikë, ligje në Kuvend e marrëveshje me Serbinë në shtet", tha zoti Kurti. Debati është përcjellë me protesta të veprimtarëve të kësaj lëvizjeje, por edhe të një grupi organizatash jo-qeveritare që kundërshtuan miratimin e ligjit për amnistinë.

Projektligji mori mbështetjen e partive në pushtet dhe Lidhjes Demokratike e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në opozitë, ndërsa u kundërshtua ashpër nga Lëvizja Vetëvendosje. Kryetari i kësaj lëvizjeje, Albin Kurti tha se nëpërmjet tij po amnistohen edhe veprimet e zyrtarëve të Kosovës

Nga **Michelle Martin**

Margot Woelk i kaloi vitet e fundit të Luftës së Dytë Botërore duke ngrënë ushqime nga më të zgjedhurat e më të shijshmet, e njëkohësisht duke u dridhur se çdo kafshatë që fuste në gojë mund t'i sillte vdekjen.

Puna e e saj në jetë ishte të provonte e para gjellët e përgatitura për Adolf Hitlerin, të cilat i shërbeheshin në një pjatë ushqim, që ajo ishte e detyruar ta hante çdo ditë mes orës 11 dhe 12 për më shumë se 2 vite e gjysëm të fundit të jetës së udhëheqësit nazist gjerman.

Nëse gjithçka shkonte mirë dhe ajo nuk sëmurej, ushqimi i paketuar në kuti i dërgohej Hitlerit në "Strofkullën e Ujikut", siç quheshin zyrat qendrore ushtarake që gjendeshin në thellësi të pyllit aty ku sot gjendet Polonia verilindore.

"Hitleri ishte vegjetarian, kështu që gjithë gama e ushqimeve ishte vegjetariane -ushqim shumë i zgjedhur si shparguj të bardhë, fruta të mrekullueshme, specat e lulëlakër," thotë për Reutersin 96-vjeçarja berlizeze.

Woelk, si dhe 14 vajza të tjera në të njëzetat, jetonin nën frikën se çdo pjatë që hanin mund të ishte e fundit.

"Ishim gjithnjë të terrorizuara nga ideja që ushqimi mund të ishte i helmatisur, sepse në Angli donin ta

Vajza që provonte ushqimin e Hitlerit



helmonin Hitlerin dhe ai e kishte marrë vesh këtë gjë nga spiunët e tij, kështu që kishte punësuar vajza të reja që të provonin ushqimin", tha ajo.

"Qanim shumë dhe përqafonim njëra-tjetrën. Pyesnim: "A do të jemi vallë ende gjallë nesër"?

Woelk, e cila vazhdon të torturohet nga makthet e shkaktuara nga roli i saj i dikurshëm si katie testuese e ushqimit të diktatorit dhe që ka heshtur për këtë përvojë të saj për shumë dhjetëvjeçarë me radhë, që prej mbarimit të luftës, tha se ajo dhe familja e saj ishin kundër nazistëve

dhe që këtë punë e zuri "si rrjedhim i një numri koinçidencash".

E detyruar të linte apartamentin e saj në Berlin, kur bombardimi nga aleatët e shndërroi atë në të pabanueshëm, Woelk la punën si sekretare dhe shkoi të jetonte me prindërit e burrit në fshatin Gross-Partsch, atëherë pjesë e Gjermanisë Lindore e aktualisht pjesë e Polonisë.

"Kryetari i bashkisë së atjeshme ishte një nazist me peshë dhe që kishte lidhje me esesët (organizatë paraushtarake naziste) kështu që më detyruan menjëherë të bëj këtë punë. Duhet të punoja për të fituar para", tha ajo.

Asnjëherë nuk e pa Hitlerin, por rastisi të shihte qenin e tij.

Woelk tha se e kishte dëgjuar shpërthimin e 20 korrikut, 1944, të shkaktuar nga një bombë e vënë në "Strofkullën e Ujikut", nga gjeneralët e ushtrisë me qëllim vrasjen e Hitlerit.

Në atë kohë ajo bashkë me disa ushtarë po shihnin një film brenda një tende jo shumë larg zyrave ushtarake.

"Dëgjuam këtë bum të madh dhe ramë nga stolat e drunj të ku ishim ulur. Dikush thirri 'Vdiq Hitleri', por

më vonë doli se kishte plagosur vetëm dorën".

Pas këtij atentati të dështuar, Woelk tha se iu desh të zhvendosej në një vend që mbahej nën mbikëqyrje dhe ajo vetë mbahej si e burgosur, i ishte ndaluar përdorimi i telefonit dhe mund të vizitonte prindërit e të shoqit vetëm nëse ishte e shoqëruar nga oficerë esesë.

Kur Hitleri vrau veten, në prill të 1945-ës, Woelk u arratis në Berlin ku qëndroi e fshehur. Forcat sovjetike po i afroreshin kryeqytetit gjerman dhe pak kohë më vonë ushtarët rusë e nxorën me forcë vajzën nga një strehim sulmesh ajrore dhe e përdhunuan për dy javë rresht.

14 vajzat e tjera që provonin ushqimin dhe që mbetën aty, u vranë që të gjitha, tha ajo.

Pas luftës Eoelk nisi punë në një zyrë sigurimi pensionesh dhe u habit kur, një ditë, i shoqi, të cilin e kishin kapur rusët dhe ajo e dinte të vdekur, u shfaq papritur. Për dy vjet nuk kishte marrë asnjë lajm prej tij dhe kur e pa nuk e njohu.

"Kam pasur një jetë të mbushur me ngjarje dramatike, dhe tani, në moshën 96-vjeçare, jam kthyer të jetoj në të njëjtën shtëpi ku kam jetuar para luftës", thotë ajo.

Qeveria e Kosovës është e përgatitur që të fillojë sa më shpejt negociimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim

Kosova e gatshme për negociatat për MSA-në

Kosova është shprehur e gatshme të nisë negociatat me Bashkimin Evropian për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e njohur si MSA. Kjo gatishmëri e qeverisë dhe institucioneve të tjera është shprehur në kuadër të takimit të katërt të dialogut për MSA-në të mbajtur në Prishtinë. Me këtë rast, përfaqësues të Komisionit Evropian i kanë rikujtuar autoriteteve në Prishtinë se miratimi për nisjen e negociatave për MSA-në paraqet vetëm fillimin e punës për plotësimin e detyrimeve që dalin nga kjo marrëveshje. Ata kanë ritheksuar që Kosova duhet të përkushtohet në pesë prioritetet e axhendës evropiane, siç është reforma zgjedhore, reforma në administratën publike, sundimi i ligjit, integrimi i pakicave dhe tregtia.

Zëvendësudrejtori në Drejtoratin e Përgjithshëm për Zgjerimin në Komisionin Evropian, Jost Korte ka bërë të ditur se në Bruksel kanë filluar përgatitjet e një teksti të marrëveshjes, ku para se të hapën negociatat me Kosovën, do të konsultohen me shtetet anëtare të BE-së. "Është me rëndësi të jashtëzakonshme që të sigurohemi se të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë në pajtim me këtë. Pra, na nevojitet koha para se teknikisht të fillojnë negociatat. Komisionieri Stefan Fule kur të vijë në Kosovë gjatë javës së ardhshme do të qartësojë sa i përket afatëve kohore. Ne dëshirojmë që kjo të fillojë sa më shpejt dhe presim në fillim të vjeshtës. Dëshirojmë që këto të jenë intensive dhe prapë do të kërkojnë punë të madhe nga të dyja palët. Na presin çështje të vështira", është shprehur Korte.

Në anën tjetër, Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi theksoi se qeveria e Kosovës është e përgatitur që të fillojë sa më shpejt negociimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim. Ai tha po ashtu se Prishtina zyrtare qysh në muajin shkurt 2013, ka miratuar strukturën negociuese dhe se tani po punon në ngritje të kapaciteteve të institucioneve. Sipas tij, reforma e adminis-



tratës publike vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore të qeverisë dhe se pas miratimit të pakos legjislative në fushën e administratës publike, ka nisur procesi i ristrukturimit të institucioneve qendrore dhe lokale. Ndërkaq paralajmëroi edhe se nga 1 janari do të fillojë zbatimin e sistemit të ri të pagave.

"Para nesh janë shumë sfida, por ato nuk janë të patejkalueshme. Dëshmi konkrete është përmbushja në një afat rekord e kriterëve afatshkurta për nisjen e negociatave për MSA në fushën e sundimit të ligjit, administratës publike, mbrojtjes së minoriteteve dhe tregtisë", shtoi Kryeministri Thaçi. Së shpejti, sipas Kryeministrit Thaçi do të mbahet edhe takimi i Këshillit Ndërmnisror për Reformën e Administratës Pub-

like me ç'rast do të përcaktohet korniza e re strategjike në kuadër të reformës së administratës publike.

Ndërkaq, zgjedhjet, ka shtuar Kryeministri Thaçi janë një nga temat që sigurisht se do të vazhdojnë të jenë subjekt i axhendës së reformave. Ndërkohë, përfaqësuesi i posaçëm dhe shefi i zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Samuel Zbogar ka theksuar se nisja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit është një rrugë e gjatë, mirëpo premtime.

Në këtë takim, zëvendësudrejtori për Zgjerim, Jost Korte tha po ashtu se qeveria e Kosovës ka arritur të tregojë kredibilitet në arritjet e saj, prandaj edhe BE-ja, siç thotë Korte duhet të jetë kredibël, duke i ofruar Kosovës shpërblim përkatës.

Dilemat serbe për zgjedhjet lokale në Kosovë

Qasja serbe ndaj zgjedhjeve për pushtetin lokal në Kosovë mund të dështojë rrugën evropiane të Serbisë

Kryeministri i Serbisë, Ivica Dačić, ka deklaruar se qasja serbe ndaj zgjedhjeve për pushtetin lokal në Kosovë mund të dështojë rrugën evropiane të Serbisë. Ai tha në një konferencë me gazetarë në Beograd se në fillim të muajit gusht kalon afati për dorëzimin e listave zgjedhore për zgjedhjet lokale në Kosovë dhe nëse nuk ka qasje konstruktive, mund të dështojë jo vetëm marrëveshja e Brukselit, por edhe rruga evropiane e Serbisë.

"Qëllimi ynë nuk ishte lartësimi i marrëveshjes së Brukselit, por

rruga evropiane e Serbisë", tha ai duke nënvizuar se në takimin e radhës me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi më 24 korrik në Bruksel, krahas çështjeve të telekomunikacionit dhe energjisë do të bisedohet edhe për zgjedhjet lokale në Kosovë

Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e arritur ndërmjet kryeministrave Thaçi e Dačić, parasheh një shkallë të lartë të autonomisë për komunat veriore të Kosovës të banuara me shumicë

serbe. Marrëveshja parasheh krijimin e një asociacioni të komunave serbe, që duhet të ndodhë pas zgjedhjeve lokale në Kosovë që do të mbahen më tre nëntor, një datë kjo e përcaktuar në bisedimet e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Autoritetet në Kosovë e vlerësojnë me rëndësi pjesëmarrjen e në këto zgjedhje të qytetarëve të komunitetit serb në komunat veriore të Kosovës. Ata thonë se "pjesëmarrja do t'u mundësojë zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre të ligjshëm, që

NATO: FSK me mandat të pandryshuar



BRUKSEL - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, deklaroi vlerësimin e Këshillit të aleancës se Forca e Sigurisë së Kosovës ka përmbushur kapacitetet e saj operacionale dhe është plotësisht e aftësuar që të përmbushë detyrat e caktuara nga mandati i saj në bazë të standardeve të përcaktuara nga NATO-ja. Por, misioni i saj, mbetet i pandryshuar.

Në një komunikatë të lëshuar nga selia e NATO-s në Bruksel, sekretari Rasmussen përgëzon anëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës si dhe pjesëtarët e KFOR-it që ishin përfshirë në ngritjen e kësaj force.

Në komunikatë thuhet se "Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës mbetet i njëjtë sikundër ishte gjithnjë: ndërmarrja e operacioneve të mbrojtjes civile dhe mbështetja e autoriteteve civile në përballjen me fatkeqësitë natyrore dhe emergjencave të tjera. Aleanca do të vazhdojë të sigurojë mbështetje dhe këshilla nëpërmjet ndërlidhësve të NATO-s dhe ekipit të këshilltarëve".

Në komunikatë thuhet se misioni i KFOR-it mbetet po ashtu i pandryshuar: të sigurojë mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët dhe komunitetet në Kosovë.

E ardhmja e Ballkanit perëndimorë është në dialog dhe ripajtim, thuhet në komunikatë, në të cilën ju bëhet thirrje pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve që të shqyrtojnë përfshirjen në radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për të siguruar se ajo do të jetë vërtetë një forcë shumetnike dhe përfaqësuese.

Forca e Sigurisë së Kosovës u themelua në bazë të planit të krye negociatorit të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, në bazë të të cilit edhe është shpallur pavarësia e Kosovës. Ngritja e kësaj force të cilën shqiptarë e shohin si bërthamë të ushtrisë së Kosovës, është kundërshtuar nga Beogradi, i cili vazhdon të kundërshtojë pavarësinë e Kosovës.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Ceku kishte deklaruar më herët se forca që e drejton ai është e gatshme të bëhet ushtri e Kosovës dhe se një gjë e tillë pritet të rekomandohet në mesin e vitit 2013.

do të punojnë për të ardhmen e të gjithë qytetarëve dhe për integrimin e të gjithëve në shoqërinë dhe institucionet e Kosovës".

Përfaqësuesit lokal të serbëve në veri themeluan një javë më parë atë që ata e quajnë "Kuvendi i Kosovës dhe Metohisë", duke hedhur poshtë çdo mundësi të përfshirjes së tyre në rendin kushtetues e juridik të Kosovës. Analistët serb thonë ndërkaq se çështja megjithatë mbetet në duart e autoriteteve të Beogradit dhe serbët në veriun e Kosovës do të

detyrohen të veprojnë në bazë të udhëzimeve që marrin nga Beogradi, i cili është zotuar se do të zbatojë tërë atë për të cilën është marrë vesh me Prishtinën në bisedimet e Brukselit.

Marrëveshja i mundësoi Kosovës hapjen e negociatave për stabilizim asocim me Bashkimin Evropian, ndërsa Serbisë, ato për anëtarësim në janar të vitit që po vjen. Por, data e saktë e fillimit të tyre, varet nga zbatimi në terren i marrëveshjes me Kosovën.